

NAMAZI I UDHËTARIT

Udhëtar nuk quhet çdo udhëtar i rëndomtë, por udhëtar quhet çdo person i cili i kalon mbi 90 km prej vendbanimit ose vendlindjes së tij ose 18 orë rrugë me ecje të rëndomtë në këmbë. Argument kemi ajetin Kur'anor:

“Nëse udhëtoni nëpër tokë nuk bëni gabim me shkurto namazin dhe nëse frikoheni se ju sulmojnë ata të cilët nuk besojnë”.

(SURETU NISA 101)

Namazet të cilat shkurtohen janë:

DREKA - farz prej katër rekateve shkurtohet në dy rekate

IKINDIJA - farz prej katër rekateve shkurtohet në dy rekate

JACIJA - farz prej katër rekateve shkurtohet në dy rekate

AKSHAMI - nuk shkurtohet po ashtu edhe sabahu nuk shkurtohet por falet si në shtëpi.

Kjo sa i përket farzeve, ndërsa sa i përket suneteve ato nuk shkurtohen.

Udhëtari gjatë udhëtimit tri ditë e tri netë ose 90 km prej vendbanimit i shkurton namazet, por nëse arrin në vendin e caktuar dhe vendos të qëndrojë më shumë se 15 ditë, atëherë nuk e shkurton namazin, por nëse vendos të qëndrojë më pak se 15 ditë, e shkurton namazin.